



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA –REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Në çështjen juridike të:

AC-II-14-0032

N. M

Paditësit

Sh.M

J. M

D. M, të gjithë nga Prishtina,

Të gjithë të përfaqësuar sipas autorizimit nga a, Xh. B, Prishtinë,

Kundër :

E Paditur/ Ankues

K “K” në Fushë Kosovë. Përfaqësuar nga

Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. “ Agim Ramadani” nr. 23, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Mr. Sc. Sahit Sylejmani gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të parashtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale, Prishtinë, C.nr. 1246/07 të datës 07/10/2010 në seancën vendimmarrëse të mbajtur më 16/07/ 2020, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

1. Ankesa e të paditurës është e bazuar.
2. Ndryshohet , Aktvendimi i Gjykatës Komunale, Prishtinë, C.nr. 1246/07 i datës 07/10/2010.
3. Refuzohet, propozimi i paditësve për caktimin e masës së sigurisë.
4. Nuk caktohen taksa gjyqësore në procedurën ankimore.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me datë 25 mars 2005, përfaqësuesi i paditësve av. Xh. B ka ushtruar padi për vërtetim pronësie në Gjykatën Komunale në Prishtinë, kundër të paditurës KBI “K” në Prishtinë.

Me datë 12 maj 2006, përfaqësuesi i paditësve av. Xh B ka ushtruar padi për vërtetim pronësie në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, kundër të paditurës K “K” në Prishtinë.

Paditësit pohuan se prona, ngastra kadastrale nr, 1675, fleta poseduese 4143 ne sipërfaqe prej 0.85,55 ari zyra kadastrale Prishtinë (me tutje prona kontestuese) e cila tani evidentohet ne emër te paditurës i është dhënë paraardhësit të tyre nëshfrytëzim që nga viti 1951 . E njëjta akoma është ne shfrytëzim, tani të pasardhësve të ndjerit Sh M.

Padisë i bashkëngjitën Fletën poseduesnr. 4143 tëdatës 15/03/2005 sipas së cilës ngastra kadastrale nr. 1675 evidentohet ne emër tëpaditurës. Vërtetimpër regjistrimin e banesës nr. 61 tëdatës 25/11/49. Aktvendimi nr. 4027 tëdatës 20/02/1951, Certifikatat e lindjes së paditësve , certifikata e vdekjes së Sh M si dhe kërkuan dëgjimin e dy dëshmitareve, N G si dhe R H.

Ata kërkuan vërtetimin e pronësisë ndaj pronës kontestuesenëbazëtë parashkrimin fituese si dhe tëdetyrohet e paditura ,lejimin e regjistrimit të kësaj pronenëemërtëpaditësve. Gjithashtu i kërkuan edhe shpenzimet procedurale..

Me datë 24 prill 2007, Dhoma e Posaçme ka nxjerr Aktvendim SCC-06-0218, me të cilin çështjen juridike i përcjell Gjykatës Komunale në Prishtinë. Në rast ankese, ajo

duhet të depozitohet pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Ky aktvendim ishte përfundimtar, ligjërish i detyrueshëm dhe pa të drejtë ankese.

Me datë 16 prill 2008, Gjykata Komunale në Prishtinë, merr aktvendim me të cilin kontestin gjyqësor C.nr. 1246/07, caktohet Q. H ekspert gjyqësor i gjeodezisë nga lista e ekspertëve të gjykatës që këtë çështje ta vërtetojë me ekspertizë.

Më 15/12/2008 në Gjykatë paraqitet edhe Raporti i Ekspertit Q. H.

Me datë 30 gusht 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë, me aktvendimin C.nr. 1246/07, të paditurës i dërgohen padia, provat e bashkangjitura, ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë së datës 15 dhjetor 2008, dhe udhëzohet e paditura të jep përgjigje me shkrim në padi brenda afatit prej 15 ditësh.

Me datë 07 shtator 2010, AKP e paraqet përgjigjen në padi. . AKP-ja pohoi se prona kontestuese i është dhënë Sh. Z vetëm nëshfrytëzim . Paditësit e nuk kanë vërtetuar legjitimitetin aktiv ndërsa sipas nenit 29 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore pronësore Juridike, “mbi sendin në pronësi shoqërore e drejta e pronësisë nuk mund te fitohet me parashkrim fitues. Andaj AKP-ja kërkoi që padia të refuzohet si e pa bazuar.

Me datë 22 shtator 2010, përfaqësuesi i paditësve ka ushtruar parashtresë me propozim të caktimit të masës së përkohshme të sigurisë kundër të paditurit K “K” në Fushë Kosovë, me ndalimin e tjetërsimit, shitjes së pasurisë nga fleta poseduese nr. 4143 zk Prishtinë, ngastrës kadastrale nr. 1675, në vendin e quajtur “V” arë e klasit të IV, në sipërfaqe prej 0.85,55 ha, e regjistruar në fletën poseduese nr. 1443 ZK Prishtinë, deri në përfundim të këtij kontesti. Lidhur me këtë kërkesë te paditësve më 07/10/2010 efshtë mbajtur një seance degjimore.

Me datë 07 tetor 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktvendimin C.nr. 1246/07, aprovohet propozimi i paditësve ,ashtu që të paditurës K “K” – AKP në Prishtinë, i ndalohet tjetërsimi, shitja e ngastrës kadastrale nr. 1675, në vendin e quajtur “Veternik” arë e klasit të IV, në sipërfaqe prej 0.85,55 ha, e regjistruar në fletën poseduese nr. 1443 ZK Prishtinë, deri në përfundim të këtij kontesti.

Mëdatë 18 tetor 2010, Agjencia Kosovare e Privatizimit ka ushtruar ankesë në Dhomën e Posaçme, kundër Aktvendimit C.nr. 1246/07, të Gjykatës Komunale në Prishtinë (më tutje Aktvendimi i ankimuar)për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore „Aktvendimi shpallur në seance gjyqësore nuk i është dorëzuar asnjëherë palëve, Për më tepër paditësit nuk ka dorëzuar Aktvendimin e trashëgimisë me të cilin dëshmohet legjitimiteti aktiv. Prona është dhanë për shfrytëzim . Ne pikën 3 të vendimit ...” shfrytëzuesi token e dehen duhet të kthej menjëherë shtetit. Ndërsa sipas nenit 28 të LMTHPJ paditësi nuk ka dëshmuar se ishte në posedim të përhershëm, ndërsa neni 29 i të njëjti Ligj , prona shoqërore nuk munda të fitohet me parashkrim fitues.

Me tej AKP-ja pohoj se paditësit me asnjë provë nuk dëshmuar se kushtet e nenit 55. 1 të Urdhresës Administrative 2008/6 për lëshimin e masës së përkohshme janë plotësuar.

AKP-ja kërkon nga Kolegji të Apelit të DHPGJS që të Aprovohet ankesa si e bazuar , të anulohet aktvendimin e ankimuar .

Me datë 04 mars 2011, përfaqësuesi i paditësve ushton parashtresë për vazhdimin e seancës dhe përfundimin e kësaj çështjeje juridike.

Me datë 19 dhjetor 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë me aktvendimin C.nr. 1246/07, ndërpret gjykimin në këtë çështje juridike deri në momentin e kthimit të dokumentacionit – regjistrit kadastral nga Serbia në Kosovë.

Me datë 21 mars 2012, DHPGJS lëshon Urdhër (SCA -10-0082) me të cilin urdhërohet Gjykatën Komunalenë Prishtinë që menjëherë ta dërgon lëndën nr. C.nr. 1246/07, në Dhomën e Posaçme.

Me datë 26 mars 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë, përmes aktit përcjellës i dorëzon, shkresat e lëndës C.nr. 1246/07, sipas urdhrit SCA -10-0082, Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme

Kolegji i Specializuar –II- i Dhomës së Posaçme, pas shqyrtimit të dokumentacionit, konstatoi se në bazë të dispozitës së Ligjit të DHPGJS-së, Ligji Nr. 04/L-033, në bazë të Vendimit e Presidiumit të DHPGJS-së për këtë lëndë specifike, ka vendosur që të

mbyll shkresat e lëndës dhe ta referojë lëndën pranë Kolegjit të Ankesave, duke i caktuar lëndës një numër të ri lëndor.

Më 05/06/2020 Ankesa e AKP-se i është servuar përfaqësuesit të paditësve.

Më 23/06/2020 paditësit parashtuan përgjigje ndaj ankesës . Ata kundërshtuan të gjitha thëniet e AKP-së . Paditësit pohuan se ata janë trashëgimtarë legjitim të paraardhësit të tyre , pronën kontestuese e kane ne posedim që nga viti 1951 ndërsa neni 29 i LMTHPJ ne te cilat thirrret AKP-ja është abroguar qysh më 1996. Më tutje Paditësit pohuan besueshmëria ndaj te drejtës së pretenduar është e madhe gjithashtu edhe rreziku nga shitja apo transferimi është i madhe . Andaj kërkuan nga Kolegji i Apelit qe ankesën e AKP-sëtë refuzojnë si të pa bazuar.

Arsyetimi ligjor

Ankesa është e bazuar.

Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës sipas nenit 69.1 të Ligjit nr.06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Aktvendimi i ankimor nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor andaj duhet anuluar.

Kriteret se kur duhet të lëshohet masa e sigurimit, përcaktohen në nenin 61 të Ligjit për Dhomën e Posaçme: Pala duhet të ofrojë dëshmi të besueshme se do të rezultojë me humbje dhe dëmtim të drejtpërdrejtë dhe të pariparueshëm nëse nuk miratohet kërkesa. Këto kriteret janë përcaktuar në atë mënyrë që nëse ndonjëra nga të mësipërmet mungon, kërkesa do të refuzohet.

Kërkesa për dëshmi të besueshme i përmban që të dyja: propabiliteti se ekziston e drejta e kërkuar = presupozimi i bazës së mjaftueshme ligjore, dhe rreziku i dëmtimit i pashmangshëm dhe i pariparueshëm ndaj kësaj të drejte, pasi që humbja dhe dëmtimi i drejtpërdrejtë dhe i pariparueshëm mund të ndodhë vetëm nëse ekziston në të vërtetë e drejta e pretenduar (shih jurisprudencën e përhershme të Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së: cf., interalia, ASC-10-0079, ASC-10-0081, ASC-10-0017, ASC-10-

0049, ASC-10-0088, AC-I-14-0309).

Nëse iu referohemi provave të ofruara nga paditësit, është e qartë se asnjë prej tyre nuk ofron bazueshmëri për ekzistimin e së drejtës së pretenduar lidhur me pronën kontestuese. Mungesa e probabilitetit ndaj së drejtëssë pretenduar është kusht i mjaftueshëm që të refuzohet një propozim për masë të përkohshme. Masa e përkohshme duhet të lëshohet vetëm nëse paditësi dëshmon me prova valide, gjegjësisht se posedon me një titull juridik, që le për të kuptuar se paditësi ka shumë gjasa që ta fitoj edhe padinë në meritat e saj. Megjithatë, në rastin konkret, ende nuk kemi një përshtypje të tillë as *prima facie*. Prona kontestuese evidentohet në emër të paditurës.

Pretendimi se ata kanë qenë shfrytëzues me mirëbesim të kësaj prone, nuk është argument ligjor për lëshimin e masës së përkohshme.

Gjithashtu, Rreziku nga shkaktimi i demit të menjëhershëm dhe të pa riparueshëm nuk është dhënë nga paditësit.

Nga këto arsye Kolegji i Apelit vlerëson se Gjykata Themelore në Prishtinë nuk ka vendosur saktësisht se kushtet e dhëna në nenin 55. 1 të Urdhëresës Administrative 2008/6 tani neni 61 të Ligjit të LDHP-së janë përmbushur në këtë rast specifik, prandaj ankesa duhet të aprovohet dhe Aktvendimi i ankimuar duhet të anulohet. Ndërsa kërkesa për caktimin e masës së sigurisë duhet të refuzohet si e pa bazuar.

Mbi bazën e këtyre arsyeve e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore:

Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën pasi që lista e taksave gjyqësore që ka hyrë në fuqi për DHPGJS-në më 27 mars 2014 nuk mund të aplikohet për rastet në pritje në mënyrë retroaktive.

U vendos nga Kolegji i Ankesave në DHPGJS, më 16/07/2020

Ilmi Bajrami , Gjyqtar Kryesues
